

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7942
E enjte, 28 nëntor 2024
Çmimi 0.50

“Dita e Forcës” mbledh vizitorë në kazemat e FSK-së | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NIS PROCESIN PËR HAPJE TË FABRIKËS PËR PRODHIM TË MUNICIONEVE | FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se ka nisur procesin drejt hapjes së një fabrike për prodhimin e municionit dhe për laboratorë për dizajnim të fluturakeve pa

pilotë, të njohur si dronë. Në fillim të mbledhjes të së mërkurës të Qeverisë së Kosovës, Kurti bëri të ditur se është nënshkruar vendimi për themelimin e një komisioni

ndërmintor që ka për qëllim vlerësimin dhe nisjen e këtij procesi. Ai tha se ky është “një hap i domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të ushtrisë”

ÇADRAKU NË SPECIALE: SHUMË DOKUMENTE QË MË JANË PREZANTUAR KANË SIGLËN E MUP-IT TË SERBISË | F. 6



SALI BERISHA LIROHET NGA ARRESTI SHITËPIAK | F. 8



AKTUALE



KONFIRMUOHET PËRBËRJA E RE E KOMISIONIT EVROPIAN, MANDATI NIS MË 1 DHJETOR | F. 2

FESTA E MADHE E 28 NËNTORIT, TAKOHEN RAMA DHE HAMZA NË TIRANË | F. 5

GJENDEN ESHTAT E NJË VIKTIME, QË POTENCIALISHT MUND TË JETË NË LISTËN E PERSONAVE TË ZHDUKUR | F. 7


EKONOMI



QEVERIA IU NDAN KOMUNAVE 15 MILIONË EURO PËR T'I MBULUAR PAGAT NË ARSIM | F. 8

KURTI MERR PJESË NË PROMOVIMIN E PROJEKTIT PËR “MODERNIZIMIN E PLOTË TË RRJETIT VALA” | F. 8

SPORT



MIRATOHET PROJEKTIGJI PËR LOJËRAT MESHDETARE ‘PRISHTINA 2030’ | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Konfirmohet përbërja e re e Komisionit Evropian, mandati nis më 1 dhjetor

BRUKSEL, 27 NËNTOR - Parlamenti Evropian me shumicë votash ka konfirmuar të mërkurën përbërjen e re të Komisionit Evropian, që në pesë vjetët e ardhshëm përsëri do të drejtohet nga Ursula von der Leyen.

Për përbërjen e re të Komisionit Evropian 370 deputetë votuan për, 282 ishin kundër, ndërsa 38 abstenuan.

Para votimit në seancë plenare u zhvillua një debat, në të cilin Ursula von der Leyen paraqiti edhe një herë përbërjen e Komisionit në mandatin e saj të dytë si presidente e ekzekutivit të BE-së.

Gjatë fjalimit, Von der Leyen premtoi se Komisioni do të angazhohet për një Evropë më të fortë, më të sigurt, e cila do të rrisë investimet për mbrojtje dhe do të vazhdojë punën drejt uljes së niveleve të ndotjes së ambientit, si dhe digitalizimin dhe rritjen e konkurrencës së ekonomisë evropiane në skenën globale.

Parlamenti Evropian e kishte caktuar votimin për këtë seancë plenare pasi mes grupimeve kryesore politike ishte arritur pajtim për konfirmimin e të 26 komisionarëve të propozuar,

ndërkohë që Von der Leyen ishte konfirmuar gjatë verës.

Të gjithë komisionarët më parë kaluan përmes seancave dëgjimore në komisionet përkatëse të PE-së dhe secili prej tyre ka marrë mbështetjen për të ushtruar postin e komisionarit në fushën që i është caktuar. Për herë të parë pas 25 vjetësh asnjë kandidat për anëtar të Komisionit Evropian nuk u refuzua nga komisionet e Parlamentit Evropian.

Mospajtimet ishin tejkuluar mes tri grupeve proevropiane, Partisë Popullore Evropiane (EPP) që është grupi më i madh, Socialistëve dhe Demokratëve (S&D) që është grupi i dytë për nga madhësia dhe grupit të liberalëve, i cili ka shënuar rënie dhe është grupi i pestë për nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Këto tri grupe së bashku kishin shumicën e mjaftueshme për ta votuar në seancë plenare Komisionin e ri Evropian. Por, pavarësisht kësaj pati deputetë edhe nga këto grupime që votuan kundër konfirmimit të Komisionit Evropian. Ato vota pastaj u kompensuan me vota nga disa grupime të tjera politike si të gjelbrit, por edhe disa nga



radhët e grupimeve të së djathtës ekstreme.

Me rajonin e Ballkanit Perëndimor në pesë vitet e ardhshme pritet që më së shumti të merret komisionarja e ardhshme për zgjerim, Marta Kos, nga Sllovenia, dhe përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas. Që të dyja, gjatë seancave dëgjimore, kanë premtuar se do të angazhohen që në pesë vjetët e ardhshëm zgjerimi i Bashkimit Evropian të bëhet realitet.

Ursula von der Leyen në fjalimin e saj tha se vendet kandidatë, si ato nga Ballkani Perëndimor, ashtu edhe Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia, e kanë vendin në BE. Shefja e Komisionit Evropian

përsëriti se pret nga komisionarja për zgjerim, Marta Kos, që të punojë për ta përgatitur BE-në për zgjerim dhe për t'i ndihmuar vendet kandidatë që të avancojnë në procesin e integritimit evropiane.

Von der Leyen tha se procesi i zgjerimit do të vazhdojë duke respektuar parimin e meritave individuale të vendeve kandidatë në procesin e reformave.

Përbërja e re e Komisionit Evropian ka 14 anëtarë nga Partia Popullore Evropiane (EPP) që është edhe grupi më i madh politik në Parlamentin Evropian. Ndërsa liberalët do të kenë 5 anëtarë në Komisionin

Evropian, edhe pse kanë shënuar rënie të madhe në zgjedhjet e fundit evropiane duke dalë në pozitën e pestë për nga numri i deputetëve në PE.

Socialistët dhe Demokratët, që mbeten grupi i dytë për nga madhësia në Parlamentin Evropian, kësaj radhe do të kenë vetëm 4 anëtarë në Komisionin Evropian.

Dy komisionarë vijnë nga radhët e partive të ekstremit të djathtë ndërsa një, Marosh Shefçoviq nga Sllovakia, nuk i takon asnjë grupimi pasi partia e kryeministrit sllovak është përjashtuar nga grupimi i Socialistëve dhe Demokratëve për shkak të mospajtimeve në qëndrimet ndaj Rusisë dhe bashkëpunimit me të djathtën ekstreme.

Konfirmimi i përbërjes së re të Komisionit Evropian në seancën plenare të së mërkurës ka hapur mundësinë që mandati i ri pesëvjeçarë të nisë të dielën më 1 dhjetor. Ky mandat do të zgjasë deri në vjeshtën e vitit 2029. Po atë ditë, më 1 dhjetor, do të nisë edhe mandati i presidentit të ri të Këshillit Evropian, Antonio Costa.

Pas 14 muajsh luftime, nis armëpushimi mes Izraelit dhe Hezbollahut

JERUSALEM, NËNTOR - Izraeli dhe militantët e Hezbollahut në Liban filluan një armëpushim të mërkurën, në një hap të rëndësishëm drejt përfundimit të luftimeve që kishin nisur gati 14 muaj më parë.

Disa të shtëna festive u dëgjuan në pjesë të periferisë jugore të Beirutit, pjesë që ishte goditur rëndë gjatë dy muajve të fundit të luftimeve. Por, nuk është raportuar për shkelje të armëpushimit.

Pas fillimit të armëpushimit në orën 4 të mëngjesit, sipas kohës lokale, ushtria izraelite paralajmëroi civilët që të mos ktheheshin ende në shtëpitë e



tyre në Libanin jugor dhe të mos u afroreshin pozicioneve izraelite. Megjithatë, shumë civilë kaluan

në Libanin jugor, duke sfiduar si paralajmërimin izraelit, ashtu edhe apelin e Ushtrisë Libaneze, e cila pritet të

dislokohe në atë zonë për të zëvendësuar forcat izraelite. Hezbollahu, i cili e kontrollon Libanin jugor, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike.

Izraeli ka deklaruar se do të sulmojë nëse Hezbollahu shkel marrëveshjen, dhe një zëdhënës ushtarak izraelit, në një postim në gjuhën arabe në platformën X, paralajmëroi banorët e evakuuar të Libanit jugor që të mos kthehen ende në shtëpitë e tyre, duke thënë se

ushtria mbetet e vendosur atje. Armëpushimi përfshin fillimisht një ndalim të luftimeve për dy muaj dhe kërkon që Hezbollahu të largojë trupat e armatosura nga Libanin jugor, ndërsa trupat izraelite duhet të kthehen në anën e tyre të kufirit.

Mijëra trupa të tjera libaneze dhe paqeruajtëse të OKB-së do të dislokohe në jug, ndërsa një panel ndërkombëtar i kryesuar nga Shtetet e Bashkuara do ta monitorojë zbatimin e këtyre procedurave.

Australia çon përpara ligjin që ua ndalon fëmijëve rrjetet sociale

CANBERRA, 27 NËNTOR - Dhoma e Përfaqësuesve në Australi ka miratuar të mërkurën një projektligj që do të ndalonte fëmijët deri në moshën 16-vjeçare të përdorin rrjetet sociale. Tani, finalizimi i këtij ligji, të paprecedentë në botë, është në dorën e Senatit të Australisë. Partitë kryesore mbështetën

projektligjin që parasheh gjoba deri në 50 milionë dollarë australianë për platformat si TikTok, Facebook, Snapchat, Reddit, X dhe Instagram, për dështime sistematike në parandalimin e hapjes së llogarive nga fëmijët.

Ligji u miratua me 102 vota pro dhe 13 kundër. Nëse projektligji bëhet ligj këtë



javë, platformat do të kenë një vit kohë për t'i zbatuar kufizimet e moshës përpara

se të fillojnë ndëshkimet. Deputeti i opozitës, Dan Tehan, tha se Qeveria kishte rënë dakord të pranonte ndryshimet në Senat që do të përforcojnë mbrojtjen e privatësisë. Platformat nuk do të lejohen të detyrojnë përdoruesit të japin dokumente identifikimi të lëshuara nga qeveria, përfshirë pasaportat ose

patentat, dhe as të kërkojnë identifikim dixhital përmes një sistemi qeveritar. "A do të jetë e përkryer? Jo. Por, a është ndonjë ligj i përkryer? Jo, nuk është. Por, nëse ndihmon, edhe nëse ndihmon në mënyrën më të vogël, do të bëjë një ndryshim të madh në jetët e njerëzve", tha Tehan në Parlament.

Çadraku në Speciale: Shumë dokumente që më janë prezantuar kanë siglën e MUP-it të Serbisë

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 27 NËNTOR- Ish-kreu i G2-shit në Zonën Operative të Pashtrikut, Halil Çadraku, gjatë dëshminë e tij në Gjykatën Speciale në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka thënë se shumë dokumente që i janë prezantuar atij e përmbajnë siglën e shërbimit serb – MUP-it. “... në mesin e këtyre dokumenteve që më janë treguar mua, shumë dokumente kanë siglën e MUP-it të Serbisë”, ka thënë dëshmitari Çadraku.

Një deklaram të tillë ai e ka bërë kur i është prezantuar një dokument për të cilin ka thënë se plotësimin që iu është bërë atij me shkrim dore nuk e kishte parë asnjëherë. “Është e vërtetë se këtë dokument të plotësuar me shkrim dore poshtë, unë nuk e kam parë asnjëherë deri javën e kaluar kur mu është treguar nga prokuroria”, ka thënë Çadraku.

Dëshmitari ka thënë se nuk e kujton nënshkrimin e Tahir Sinanit, por që e ka lexuar në të njëjtin dokument se nënshkrimi i përket atij.

Për këtë dokument, dëshmitari Çadraku ka thënë është e palogjikshme të ndodhë për shkak se të njëjtin dokument ai ia ka dhënë Tahir Sinanit më 18 gusht dhe tani po figuron edhe një i ngjashëm më 19 gusht 1999.

Ai ka thënë se ka dyshime për këtë dokument që mund të jetë edhe i falsifikuar. “I kam thënë edhe prokurorit se vërtetë nuk ka kuptim, nuk ka kuptim kjo se një ditë më herët e kam shkruar të njëjtin artikull që ia kam dedikuar Tahir Sinanit, kurse një ditë më vonë të shkruaj të njëjtin gjë, ju lutem unë nuk e di. Unë kërkoj



edhe njëherë nga gjykata e nderuar... në mesin e këtyre dokumenteve që më janë treguar mua, shumë dokumente kanë siglën e MUP-it të Serbisë. Është e pak e palogjikshme. Unë jam arrestuar në vitin 2001 në Prizren, dokumentet kanë shkruar në Serbi dhe nga Serbia kanë ardhur këtu. Ky dokument mund të jetë edhe i falsifikuar edhe i plotësuar meqë janë të gjitha këto fotokopje. Por, mua ky dokument me duket i palogjikshëm sepse të njëjtin e kam shkruar pa këtë plotësim me dorë një ditë më herët. Kështu që kam dyshime për këtë. Nuk e kujtoj dhe nuk di se çfarë të iu them”, ka thënë Çadraku.

Dëshmitari ka thënë se Kadri Veselin e kishte parë më 2 prill 1999, datë kjo që ishte

përfundimtare për shërbimin e tij në Zbulim-Kundërzbulim. “Edhe sot e mendoj që nga 1 apo 2 prill (1999), Kadri Veseli ka qenë... ndoshta ka qenë edhe jashtë vendit atje por ka qenë i emëruar drejtor i Shërbimit Informativ në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës që është pjesë civile e udhëheqjes”, ka thënë Çadraku. Dëshmitari ka thënë se nuk ka pasur raste që ka hetuar persona të cilët janë cilësuar si bashkëpunëtor ose të kenë marrë masa ndaj tyre. “E kam thënë. Ne nuk kemi qenë të interesuar për këtë pjesë të investigimit apo hetimit”, ka thënë ai.

Gjithashtu, dëshmitari Çadraku është pyetur se a është e vërtetë që ka pasur persona në territorin e tij që civilët ose ushtarët mendonin

që përbënin rrezik.

Madje, dëshmitari ka thënë se nuk i ka kërkuar asnjëherë policisë ushtarake që të hetohen njerëz të dyshimtë. “Nuk mbaj mend diçka konkretisht për këtë. Nuk me kujtohet ndonjë rast specifik. Me sa mbaj mend unë kurrë nuk i kam kërkuar Policisë ushtarake që të hetohen njerëzit e dyshimtë që jetonin jashtë trevave tona ku ishim ne”, është përgjigjur dëshmitari Çadraku.

Për Ferat Shalën dhe Ilmi Reçicën, dëshmitari ka thënë se i ka njohur pas luftës dhe se nuk e di se çfarë kanë bërë gjatë periudhës së luftës.

Ai ka thënë se ka dëgjuar që ata kanë qenë pjesë e G2-shëve në Zonën e Drenicës dhe atë të Nerodimës.

Çadraku: Ka ndodhë që pas luftës të shkruhen libra për propagandë

Duke u përgjigjur në pyetjet e avokates së Hashim Thaçit, Nina Tavakoli, dëshmitari Halil Çadraku është pajtuar se shumë persona kanë filluar pas luftës që të shkruajnë libra për të ekzagjeruar ose zbuluar rolin që ata kanë pasur gjatë luftës.

Madje, ai ka thënë se kjo gjë është bërë për propagandë në mënyrë që ta rrisin vetën e tyre. Ai në një rast, ka thënë se nuk i ka raportuar ndonjëherë Rexhep Selimit. “Po zonjë ka ndodhur shumë shpesh që dikush të botojë ndonjë libër për propagandë, për dëshirat e tyre, për ta rritur vetën, për të treguar diçka më shumë. Unë nuk jam një njeri i tillë dhe nuk kam shkruar për vete kurrë. Kam shkruar ndoshta opinione të shkurtra në rrjete sociale, por jam i vetëdijshëm dhe e di që shumë njerëz kanë shkruar libra jo ndoshta të bazuara në shkencë apo në realitetin”, ka thënë Çadraku.

Dëshmitari Halil Çadraku, ka thënë se gjatë kohës sa ka vepruar në Zvicër nuk e ka njohur Thaçin dhe as nuk ka pasur kontakt me të. “Zonjë nuk kam pas kontakt dhe as nuk e kam njohur Hashim Thaçin në Zvicër”, ka thënë Çadraku.

Çadraku ka pohuar se në një rast kishin hyrë nga Shqipëria së bashku me Thaçin dhe një grup ushtarësh por që tashmë të akuzuarin atë kohë nuk e kishte njohur.

Ai ka thënë se nuk ka pasur raste kur ka pasur komunikime me Thaçin gjatë kohës së luftës.

Sali Berisha lirohet nga arresti shtëpiak



TIRANË, 27 NËNTOR - Gjykata e Posaçme në Shqipëri ka vendosur të mërkurën ta lirojë ish-kryeministrin Sali Berisha nga masa e sigurisë “arrest shtëpie”.

Kjo masë ndaj Berishës ishte vendosur gati një vit më parë, më 30 dhjetor të vitit të kaluar pasi ish-kryeministri kishte refuzuar detyrimin për t'u paraqitur në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Ai ishte ftuar të paraqitet para SPAK-ut për t'u marrë në pyetje në lidhje me hetimet ndaj tij për korrupsion në procesin e privatizimit të ish-kompleksit sportiv “Partizani”.

Avokati i tij, Genc Gjokutaj, tha për mediat se, mbi bazën e kërkesës së tij, gjykata vendosi ta lirojë Berishën nga masa e arrestit shtëpiak. “Gjykata konstatoi se nuk ekzistojnë më kushtet e as kriteret për asnjë lloj mase sigurimi ndaj Berishës.

Prokuroria kërkoi që ai të mbetej në arrest shtëpiak, por sot nuk ka asnjë masë tjetër sigurimi ndaj tij”, tha Gjokutaj.

Avokati i Berishës shtoi se vendimi për ta liruar Berishën nga “arrest shtëpiak” është i zbatueshëm menjëherë. Pritet reagimi i Prokurorisë nëse do të apelojë këtë vendim.

Ish-kryeministri Berisha ndodhet nën hetim prej tetorit të vitit të kaluar për akuzën e korrupsionit pasiv.

Në atë kohë ndaj tij u vendos masa e sigurimit “detyrim paraqitje” dhe “ndalim i daljes jashtë shtetit”. Masa u rëndua në “arrest shtëpie” pasi ish-kryeministri Berisha refuzoi ta zbatonte vendimin e gjykatës.

Më 21 nëntor, Gjykata Kushtetuese pranoi pretendimin se bllokimi i pasaportës ishte joproporcional dhe se masa “detyrim paraqitjeje” ishte mjaftueshme.



Kosova nis procesin për hapje të fabrikës për prodhim të municioneve

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se ka nisur procesin drejt hapjes së një fabrike për prodhimin e municionit dhe për laboratorë për dizajnim të fluturakeve pa pilotë, të njohur si dronë. Në fillim të mbledhjes të së mërkurës të Qeverisë së Kosovës, Kurti bëri të ditur se është nënshkruar vendimi për themelimin e një komisioni ndërministror që ka për qëllim vlerësimin dhe nisjen e këtij procesi. Ai tha se ky është “një hap i domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të ushtrisë”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 NËNTOR - “Ditën e Forcës së Kosovës po e shënojmë me një vendim të rëndësishëm dhe një hap të domosdoshëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të ushtrisë sonë. Komisioni ndërministror i përbërë nga ministri i Mbrojtjes, ministrja e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve dhe ministri i Punëve të Brendshme, do të nisë procedurat e nevojshme për hapjen e fabrikës për

prodhimin e municionit dhe për laboratorin mbi dizajnimin e fluturakeve pa pilotë në Republikën e Kosovës”, ka thënë kryeministri Albin Kuri në mbledhjen e kabinetit qeveritar të mërkurës. “Një ushtri që për një kohë kaq të shkurtër është armatosur kaq shumë sa kjo e jona, ka nevojë për ta siguruar e garantuar operacionalitetin e plotë dhe qëndrueshmërinë tërësore. Andaj, me sot hedhim hapat tonë të parë për ngritjen e industrisë ushtarake. Për më shumë, në lidhje me këtë dhe me shënimin e Ditës së

Forcës, në konferencë për media do t’ju flasë ministri jonë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci”, është shprehur kryeministri. Kurti ka thënë se qeveria nën drejtimin e tij ka treguar që mbrojtja ka qenë ndër prioritetet e tij kryesore. “Kjo është dëshmuar në vazhdimësi si me numrin e ushtarëve që është dyfishuar, si me buxhetin për Ministrinë e Mbrojtjes që është trefishuar, si me trajnimet jashtë vendit të oficerëve dhe ushtarakëve tanë që janë katërfishuar, si me investimet në armatim që janë

shumëfishuar”, është shprehur Kurti. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, tha se për këtë projekt janë koordinuar me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë ShBA-në, dhe se Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka asistuar me një “raport fizibiliteti”. “Për hapjen e fabrikës shtetërore të municionit, kemi pranuar një raport fizibiliteti nga Ministria e Mbrojtjes e Turqisë. Jemi në fazën e finalizimit të këtij projekti”, tha Maqedonci, në një konferencë për medie. Ai shtoi se municionet e prodhuara se do të jenë sipas standardeve të NATO-s. Verën e kaluar, Kosova bleu dronë Bayraktar TB-2 nga Turqia. Kurti tha asokohe se me blerjen e tyre, Kosova “është edhe më e sigurt”, dhe shtoi se oficerët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë trajnuar tashmë për përdorimin e dronëve. Se sa dronë ishin blerë, nuk ishte bërë e qartë atë kohë.

Buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2025 është paraparë të jetë 207.8 milionë euro, apo 54 milionë euro më shumë sesa këtë vit. Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua më 1 janar të vitit 2009, pas shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). FSK-ja është aktualisht në proces të transformimit të ushtri të rregullt. Deri në fund të këtij procesi, më 2028, FSK-ja pritet t’i ketë mbi 7.500 pjesëtarë aktivë dhe rezervistë nga mbi 4.000 sa i ka aktualisht. Në konferencën pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, Maqedonci, ka theksuar se iniciativa e fundit është pjesë e fazës së dytë të procesit të transformimit të FSK-së në ushtri të rregullt. “Ne së bashku me komandantin e FSK-së jemi të përkushtuar që planin për transformimin e FSK-së ta arrijmë brenda afateve kohore”, ka deklaruar

Festa e madhe e 28 Nëntorit, takohen Rama dhe Hamza në Tiranë

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Badri Hamza, ka takuar të mërkurën në Tiranë kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Takimi i Hamzës me Ramën është realizuar në

prag të festës së 28 Nëntorit. “Në Tiranë, takim me kryeministrin Edi Rama për festën e madhe të 28 Nëntorit. Qëndrojmë të bashkuar, siç kemi qenë gjithmonë, për ta nderuar trashëgiminë dhe për

të punuar së bashku për të ardhmen tonë. Kur Kosova dhe Shqipëria janë mirë, #mamirë janë të gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë!”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.



“Dita e Forcës” mbledh vizitorë në kazermat e FSK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës të mërkurën shënuan “Ditën e Forcës” me një ceremoni të veçantë dhe aktivitete të shumta. “Dita e Hapur” u mbajt në kazermat e FSK-së në Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjilan, Prizren, Ferizaj dhe Pomozatin, ku qytetarët dhe nxënësit patën mundësinë të shohin nga afër pajisjet dhe armatimet ushtarake, të ndjekin demonstrime të ndryshme dhe të marrin pjesë në aktivitete që tregojnë fuqinë dhe gatishmërinë e FSK-së. Ceremonia qendrore u zhvillua

në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë, me pjesëmarrjen e liderëve më të lartë shtetërorë, përfshirë kryeministrin Albin Kurti, ministrin e Mbrojtjes Ejup Maqedonci, komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Bashkim Jashari, zëvendësministrat Shemsi Sylja dhe Adnan Redzeplari, si dhe përfaqësues ushtarakë dhe diplomatikë nga vendet partnere. Në këtë ditë të veçantë, kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes filluan vizitën e tyre duke inspektuar kapacitetet ushtarake të FSK-së, të ekspozuara për publikun. Në fjalët e tyre drejtuar mediave, ata falënderuan komandantin e FSK-së, gjeneral Jasharin, dhe të



gjithë ushtarakët për përkushtimin dhe gatishmërinë e tyre në realizimin e misionit të

shenjtë për mbrojtjen e vendit. Me këtë rast, ministri Maqedonci, ndër tjerash theksoi se sot është një ditë e veçantë për FSK-në dhe se shënimi i 27 Nëntorit si “Dita e Forcës” është bërë tashmë një traditë, që lidhet me aktivitetet e mëhershme dhe trashëgiminë nga lufta çlirimtare, por gjithashtu tregon për zhvillimet e saj si ushtri ndër vite. Ai gjithashtu theksoi se kjo ditë u shënua me një hap të rëndësishëm për plotësimin e infrastrukturës së mbrojtjes dhe sigurisë - fillimin e industrisë ushtarake, një komponent kyç për qëndrueshmërinë shtetërore në mbrojtje dhe siguri. Ndërsa kryeministri Kurti në

fjalën e tij, ndër tjerash theksoi se FSK po forcohet vazhdimisht dhe me këtë po fuqizohet Republika e Kosovës. Ai shprehu mirënjohjen e thellë dhe falënderimin e përzemërt për Ministrinë e Mbrojtjes, ushtrinë, udhëheqësit dhe secilin që është angazhuar dhe ka kontribuar në këtë proces. Kjo ceremoni dhe aktivitetet e shumta të shënuara në këtë ditë tregojnë angazhimin dhe përkushtimin e përbashkët për forcimin dhe mbrojtjen e Republikës së Kosovës. Dita e Forcës na ofron mundësinë të falënderojmë dhe shprehim mirënjohjen më të lartë për qytetarët, të cilët janë mbështetësit më të fuqishëm të FSK-së.



Rreth 100 mijë euro i janë kursyer buxhetit të shtetit që nga funksionalizimi i Shërbimit të PET/CT

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Rreth 100 mijë euro i janë kursyer buxhetit të shtetit që nga funksionalizimi i Shërbimit të PET/CT (procedurë e detajuar diagnostikuese), në QKUK, e cila po kryhet në Shërbimin e Mjekësisë

Nukleare në QKUK. QKUK-ja ka njoftuar se nga 25 qershori i vitit 2024, e deri në fund të muajit shtator, janë kryer 69 raste. “Pacientët nuk kanë pasur nevojë të dalin jashtë QKUK-së, për të kryer këtë

ekzaminim. Përkundër kërkesave të shumta, lista e pritjes është 1 muaj e gjysmë, e jo më shumë, kurse prioritetet për kryerje të rasteve i përcakton ekipi mjekësor i përbërë nga mjekë të profileve të ndryshme,

përfshirë mjekun specialist të Onkologjisë, Mjekësisë Nukleare dhe Radiologjisë, të cilët bazuar në dokumentacionin mjekësor vendosin se cilat raste duhet të kryhen me prioritet”, ka njoftuar QKUK-ja.



Abdixhiku dhe ambasadori i Zvicrës diskutojnë për zgjedhjet e 9 shkurtit

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në selinë qendrore të partisë ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jürg Sprecher. Në këtë takim Abdixhiku dhe ambasadori Sprecher, diskutuan për zhvillimet politike në vend, me theks të veçantë për zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryetari Abdixhiku, e njoftoi ambasadorin Jürg Sprecher

lidhur me përgatitjet e LDK-së rreth zgjedhjeve, duke theksuar angazhimin e LDK-së për të realizuar programin politik "Rruga e Re", i cili përmban projekte konkrete që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

U diskutua edhe për rrugëtimin e "Turneut të Ndryshimit", si dhe mbështetjen e jashtëzakonshme qytetare që po

merr ky turne anë e kënd Kosovës, si përgjigje ndaj thirrjes tonë për ndryshim. Në fund të takimit, u fol edhe për projekte që synojnë thellimin e bashkëpunimit mes të dyja vendeve, ndërsa kryetari Abdixhiku falënderoi ambasadorin Sprecher për mbështetjen që Zvicra i ka dhënë në vazhdimësi Kosovës, në proceset demokratike dhe zhvillimore të saj.



Ambasadori britanik, Hargreaves: Dhuna me bazë gjinore problem global, qeveria t'i mbështes viktimat

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se fushata në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, ka treguar sukses dhe për këtë ka falënderuar Ambasadën e Britanisë së Madhe për mbështetjen. Në konferencën për medie, së bashku me ambasadorin britanik, Jonathan Hargreaves, Haxhiu ka thënë se qëllimi është edukimi i publikut mbi raportimin e dhunës. "Me mbështetjen e ambasadës britanike, ne kemi arritur që ta ngremë një fushatë që frymëzon veprim. Sot dhe çdo ditë tjetër mund të ndërhyjmë kur ka situata të papërshtatshme. Kjo fushatë ka adresuar disa raste kyçe. Edukimin e publikut mbi raportimin e dhunës, partneriteti ndërmjet MD-sw dhe Qeverisë britanike, ku ka sjell në Kosovë praktikën e

Britanisë së Madhe lidhur me këtë çështje", ka thënë Haxhiu. Ambasadori britanik, Jonathan Hargreaves, ka thënë se as Mbretëria e Bashkuar dhe as Kosova nuk janë immune ndaj dhunës me bazë gjinore. "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore janë një moment i rëndësishëm për të gjithë ne, për të përforcuar angazhimin tonë për të trajtuar këtë problem të përbashkët global. Dhuna me bazë gjinore është një krizë globale urgjente. Një në tre gra në mbarë botën do të përjetojnë dhunë gjatë jetës së tyre, shumë nga duart e partnerit ose të një anëtar të ngushtë të familjes. As Mbretëria e Bashkuar dhe as Kosova nuk janë immune nga kjo epidemi dhe ne të dy kemi parë rritje shqetësuese të numrit të rasteve të raportuara në forcat tona përkatëse të Policisë në vitet e fundit. Do të ishim naivë nëse mendonim se nivelet e rritura të raportimit



mund të jenë përgjegjëse për të gjitha këto. Megjithatë, ndërkohë që qeveria ka një rol të madh për të siguruar që institucionet të kenë mjetet e

duhura për t'i mbajtur autorët përgjegjës dhe për të mbështetur viktimat, ne të gjithë kemi një rol për të luajtur në luftën kundër

dhunës me bazë gjinore", ka thënë ai.

Duke u mbështetur në dëshmitë e asaj që funksionon në Mbretërinë e Bashkuar dhe nga kërkimet e kryera nga Shërbimi i Komunikimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe OJQ-të lokale, ai ka thënë se ekipi ka punuar së bashku në një fushatë profesionale, të bazuar në dëshmi, ndikimi i së cilës do të jetë i matshëm. "Ekipi identifikoi një problem - mungesën e njohurive se cilat sjellje konsiderohen si GBV, dhe si të ndërhyhet ose raportohet në mënyrë të sigurt për dhunën dhe më pas zhvilloi një fushatë të synuar për ta trajtuar atë. Fushata do të synojë kalimtarët midis moshës 18 dhe 34 vjeç, të cilët hulumtimi tregoi se ishin më të gatshëm të merrnin parasysh ndërhyrjen ose raportimin, por shpesh nuk ishin të sigurt se si ta bënin këtë", ka thënë Hargreaves.

Aksion kundër krimeve kibernetike: 20 të arrestuar, 120 mijë euro të sekuestruara



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Njëzet persona janë arrestuar dhe rreth 120 mijë euro janë konfiskuar gjatë një aksioni policor në Prishtinë, Ferizaj, Kaçanik dhe Klinë, pas dyshimeve për kryerje të veprave penale "hyrje e paautorizuar kompjuterike" dhe "mashtrim". Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës më 27 nëntor, hetimet për këtë rast kanë qenë duke u zhvilluar që disa muaj nga hetuesit e Drejtorisë për Hetim të Krimeve Kibernetike në

Policinë e Kosovës. Aksioni ka përfshirë kontrolle në 14 lokacione të ndryshme, gjatë së cilave, përveç parave, janë sekuestruar edhe pesë vetura, rreth 60 kompjuterë dhe telefona, si dhe pajisje memorizuese. Më urdhër të prokurorit nga Prokuroria Speciale, dhjetë të dyshuar janë liruar në procedurë të rregullt. Ndërsa, dhjetë të tjerë janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Në aksion morën pjesë edhe

zyrtarë gjermanë dhe prokurorë, përveç rreth 120 zyrtarëve policorë. Sipas Kodit Penal të Kosovës, për veprat penale "hyrje në sisteme kompjuterike" dhe "mashtrim" parashihet dënim me gjobë dhe me burim deri në dhjetë vjet, varësisht nga specifikat e rastit. Në Kosovë ka pasur edhe aksione të tjera në të kaluarën, si pjesë e luftës kundër krimeve kibernetike, si nëpër qendra të thirrjeve.

Ish-komandanti i FSK-së: Ushtria jonë është institucioni më i besueshëm, që na bën krenarë të gjithëve

Prishtinë, 27 nëntor - Rrahman Rama, ish-komandant i FSK-së, kandidat për deputet në listën e PDK-së, para studentëve të Universitetit

Amerikan në Kosovë ka mbajtur një ligjëratë rreth Ditës së Forcës dhe gjithë angazhimit për forcimin e saj. "Pata nderin që sot të flisja para studentëve

të RIT-it rreth Ditës së Forcës dhe gjithë angazhimit për forcimin e saj. Ritheksova se Ushtria jonë është formuar mbi vlera të trashëguara nga

Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe tani është institucioni më i besueshëm, që na bën krenarë të gjithëve!", ka shkruar ai në "Facebook".



Kadetët e FSK-së sfidojnë të ftohtin dhe borën, përfundojnë me sukses marshimin 12.8 kilometërsh

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Kadetët e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë përfunduar me sukses marshimin prej 12.8 kilometrave, që u zhvillua në rrethinën e Liqenit të Batllavës. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, në një postim në "Facebook" ka bërë me dije se kadetët treguan disiplinë dhe

vendosmëri, ani pse kushtet atmosferike ishin të rënda dhe temperaturat ishin të ulëta. "Një tjetër marshim i suksesshëm prej 12.8 km i përfunduar nga kadetët tanë në rrethinën e liqenit të Batllavës, përkundër kushteve të rënda atmosferike me temperatura të ulëta dhe reshje të dendura bore. Me

disiplinë, vendosmëri dhe një frymë të fortë bashkëpunimi, ata dëshmuar edhe një herë përgatitjen dhe përkushtimin e udhëheqësve tanë të ardhshëm ushtarak", ka shkruar Maqedonci. Ministri është shprehur krenar për suksesin dhe "shpirtin e tyre të palëkundur".



Stacioni policor në Zveçan sulmohet me dy granata dore

ZVEÇAN, 27 NËNTOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën, pak para mesnatës, ishte sulmuar stacioni policor në Zveçan, pasi drejt oborrit të stacionit ishin hedhur dy granata dore nga persona të panjohur.

Sipas Policisë, sulmi ka shkakuar dëme materiale, porse nuk ka lënë asnjë të lënduar. "Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori i Shtetit, i cili ka udhëzuar që rasti të iniciohet si 'shkaktim i rrezikut të përgjithshëm'", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës të mërkurën.

Dy ditë më parë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se në fshatin Izvor të Zveçanit, në veriun e banuar me shumicë serbe, po ndërtohej një nënstacion i ri policor.

Gjatë aktivitetit për vendosjen e gurthemelit, Kurti kishte thënë se një javë më parë ishte vendosur edhe një gurthemel për stacionin e policisë mbi urën e lumit Bistrica, e cila ndodhet në rrugën kryesore që



çon në kalimin kufitar të Jarinjës. Në këtë pikë ndodhen pjesëtarë të njëjësive speciale dhe të rregullta të Policia e Kosovës.

Përfaqësuesit e komunitetit serb kundërshtojnë ndërtimin e stacioneve policore ose bazave policore, me arsyetimin se ata janë të ekspozuar ndaj

"presioneve dhe diskriminimit" nga ana e Policisë.

Gjithashtu, sektori civil serb ka kërkuar kohët e fundit nga komuniteti ndërkombëtar që t'u kushtojë vëmendje ankesave të qytetarëve për sjelljen e Policisë së Kosovës, duke e cilësuar atë si "joprofesionale" dhe "të

politizuar".

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, e ka vlerësuar ndërtimin e stacioneve të reja si "një mjet shtesë për shtypjen dhe dëbimin e popullatës serbe".

Ai po ashtu ka deklaruar se autoritetet e Kosovës "kanë

ndryshuar në mënyrë të dhunshme strukturën etnike të policisë" në veri të Kosovës, dhe ka potencuar se Marrëveshja e Brukselit parashikon që në këtë pjesë të dislokohen policë nga radhët e komunitetit serb.

Në fillim të nëntorit 2022, mbi 500 policë nga radhët e komunitetit serb në veri të Kosovës dhanë dorëheqjen si pjesë e një aksioni kolektiv për t'u larguar nga institucionet e Kosovës për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për konvertimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia, në ato të Kosovës.

Që nga ajo kohë, në veri të Kosovës janë ndodhur kriza të shumta, që kulmuan me një sulm të armatosur të një grupi të serbëve ndaj Policisë së Kosovës në shtator 2023, kur u vra një polic i Kosovës. Ndërkohë, në veri janë dërguar kryesisht policë nga komuniteti shqiptar, si dhe pjesëtarë të njëjësive speciale të Policisë së Kosovës.

Gjenden eshtrat e një viktime, që potencialisht mund të jetë në listën e personave të zhdukur

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka njoftuar se gërmimet e realizuara sot në lokacionin Suhodoll - Mitrovicë, kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore (eshtrave) të një viktime, që potencialisht mund të jetë në listën e personave të zhdukur. "Mbetjet mortore të zhvarrosura do të

dërgohen për ekzaminimet e nevojshme mjekoligjore dhe identifikimin përmes analizës shkencore të ADN-së. Gërmimet janë realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur do t'iu mbajë të informuar për rezultatet e gjetjeve. Qeveria e Republikës

së Kosovës mbetet e përkushtuar për të vazhduar angazhimin dhe punën, duke i dhënë prioritet ndriçimit të fatit të të zhdukurve me dhunë gjatë luftës, për t'i dhënë fund ankthit 24 vjeçar të pritisë së familjarëve për të ditur vendndodhjen e më të dashurve të tyre", ka njoftuar Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur.



Diskutohet vendimi i presidentes lidhur me kthimin në rishqyrtim të Ligjit për Këshillin e Sigurisë së Kosovës



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në mbledhjen e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të mbajtur të mërkurën, kryesuar nga kryetari Bekë Berisha, u shqyrtua vendimi i Presidentes lidhur me kthimin në rishqyrtim të Ligjit për Këshillin

e Sigurisë së Kosovës. Fillimisht, kryesuesja e grupit të punës për amendamentim të këtij ligji, Shqipe Mehmeti-Selimi dha sqarimet e nevojshme rreth procedimit të ligjit, duke paraqitur në vijim edhe detaje dhe arsyeime nga presidentja dhe vërejtjet e

caktuara të saj për këtë ligj. Pas një diskutimi të gjerë të anëtarëve rreth procedimit të mëtejme të kësaj çështje, Komisioni u dakordua që të marrin opinion ligjor dhe interpretim të Rregullores për këtë nga Komisioni për Legjislacion.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Hovenier: Kuka e ka vendosur Xhudon e Kosovës në skenën globale

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ambasadori i Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier ka zgjedhur fjalët më të mira pasi pa dokumentarin e trajnerit të xhudos Driton Kuka. Ai ka thënë se ishte përkushtimi i

Kukës që e ka vendosur Xhudon e Kosovës në skenën globale. "Frymëzuar nga filmi dokumentar SENSEI: Driton Toni Kuka, Made in Kosova, një histori prekëse e arritjeve të mikut tim Toni.

Përkushtimi i tij e ka vendosur Xhudon e Kosovës në skenën globale dhe rrugëtimi i tij pasqyron qëndrueshmërinë dhe talentin e popullit të Kosovës", ka shkruar shkruar Hovenier.



Miratohet Projektligji për Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030'

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Lojërat Mesdhetare, të cilat do të organizohen në Kosovë në vitin 2030. Ky projektligj parasheh që Lojërat Mesdhetare të shpallen si çështje me rëndësi të veçantë për shtetin e Kosovës. Zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani ka thënë se ky projektligj vjen si rezultat i një analize të thellë ligjore vendore dhe ndërkombëtare dhe se përmes tij themelohet edhe Komiteti Organizativ i këtyre lojërave. "Hartimi i këtij projektligji është rezultat i një procesi të thellë të analizës duke përfshirë shqyrtimin e kornizës ligjore vendore dhe praktikave ndërkombëtare të organizimit të ngjarjeve



multisportive të ngjashme. Me miratimin e këtij projektligji Lojërat Mesdhetare shpallen çështje me interes të veçantë për Republikën e Kosovës duke reflektuar rëndësinë strategjike që ky projekt ka për vendin tonë", ka thënë Osmani, e cila

theksoi se kostoja e kësaj strategjie është mbi 338 milionë euro për periudhën gjashtëvjeçare. "Ky ligj themelon Komitetin Organizativ të Lojërave Mesdhetare 2030, një strukturë që pavarur me statusin e

fondacionit të Organizatës joqeveritare përgjegjëse për udhëheqjen e këtij aktivitet", ka shtuar Osmani. Kryesues i këtij komiteti do të jetë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili ka thënë se përmes organizimit të kësaj ngjarjeje, Kosova do të

ketë infrastrukturë moderne sportive por edhe do të promovohet në arenën ndërkombëtare. "Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030' janë ngjarja më e madhe sportive në vend dhe rajon dhe përmes investimeve do të kontribuojë drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës sportive kurse përmes mikpritjes do të kontribuojë në përfaqësimin dhe promovimin ndërkombëtar të republikës sonë", ka thënë Kurti. Të drejtën për organizimin e Lojërave Mesdhetare, Kosova e fitoi në Asambleshën e Përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare të zhvilluar në Greqi, në shtatorin e vitit të kaluar.

FFK-ja dhe Oda Ekonomike e Kosovës nënshkruajnë Memorandum Bashkëpunimi



PRISHTINË, 27 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës kanë formalizuar bashkëpunimin e tyre përmes një Memorandumi të Bashkëpunimit, i cili u nënshkrua sot në selinë e FFK-së nga presidenti Agim Ademi dhe kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna. Ky memorandum ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, për çështje që kanë të bëjnë me sponsorizimet si dhe

lehtësimin e procedurave që lidhen me aktivitetet ndërkombëtare të FFK-së. Në këtë aspekt, pjesë kyçe e këtij bashkëpunimi është përfshirja e "ATA Carnet" – një dokument ndërkombëtar që lehtëson transportimin e materialeve përmes kufijve doganorë. Ky instrument, i cili përdoret gjerësisht në mbarë botën tashmë do të jetë në funksion edhe për FFK-në, duke lehtësuar ndjeshëm qarkullimin e materialeve sportive në hyrje dhe dalje nga

Kosova. "ATA Carnet" është një dokument ndërkombëtar që përdoret për të lehtësuar eksportin dhe importin e mallrave të caktuara pa paguar detyrimet doganore dhe tatimet në vendet që e pranojnë këtë sistem. "ATA Carnet" përdoret kryesisht për mallra që nuk do të shiten ose qëndrojnë përgjithmonë në vendin ku dërgohen, e në masë të madhe përdoret për pajisje profesionale dhe sportive.

2 Korriku pëson humbje të thellë ndaj Dynamo Kyivit

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Ekipi i 2 Korrikut U19 ka pësuar humbje me rezultat 5-0 ndeshjen e parë ndaj Dynamo Kyivit në kuadër të "play-off"-it të UEFA Youth League apo Ligës së

Kampionëve për të rinj. Ekipi prishtinas nuk ka arritur të tregoj formën e tyre më të mirë në ndeshjen ndaj ukrainasve të zhvilluar në stadiumin "Stali Staloëa Ëola" në Poloni. Shënues për

Dynamon ishin Kyrilo Osypenko dhe Matvii Ponomarenko në pjesën e parë, kurse në të dytën Ponomarenko shënoi dhe dy gola të tjerë, derisa Ivan Andreyko shtoi një gol.

Ndryshe, ndeshja kthyesë parashihet të luhet më 11 dhjetor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Fituesi i kësaj ndeshjeje i bashkohet fazës së 1/16-tës në Ligën e Kampionëve për të rinj.



Guardiola shfaqet i gjakosur pas barazimit me Feyenoordin: Doja t'i bëja keq vetës

MANCHESTER, 27 NËNTOR - Është e vështirë për t'u besuar, por Manchester City ka harruar se si fitohet. Pas pesë humbje radhazi në Premier Ligë, sfida kundër Feyenoordit ishte idealja për të lënë pas këtë krizë, por në mënyrë të çuditshme, "qytetarët" dalin

sërish me kokën poshtë, kjo pasi shpërdoruan një avantazh të trefishtë përballë ekipit holandez. City avancoi 3-0, por ndeshja përfundoi 3-3. Jo vetëm rezultati, i pabesueshëm ishte edhe imazhi i Pep Guardiolas përpara mediave, i gërvishtur

dhe i gjakosur në të gjithë fytyrën e tij, por spanjoli zbuloi se nuk kishte ndodhur asnjë incident: "Këto gërvishtje i kam bërë me thonj, sepse doja t'i bëja keq vetës. Jemi të brishtë. Ishim 3-0, po luanim mirë, por më pas pësuam ato gola sepse nuk

jemi të qëndrueshëm. Është e qartë që kishim nevojë për këtë fitore, do të na jepte besim, por ja çfarë bëmë". Me 8 pikë në pesë ndeshje, për momentin Manchester City e sheh veten në vendin e 15-të, në fazën "play-off"-it të Ligës së Kampionëve.



Promovohet monografia kushtuar gazetarit sportiv Xhavit Kajtazi

PRISHTINË, 27 NËNTOR - Në ambientet e Institutit Albanologjik në Prishtinë, u promovua monografia e autorit Veli Kajtazi, e titulluar "Xhavit Kajtazi, sporti, shtetndërtimi dhe jeta publike", një vepër që i kushtohet gazetarit të mirënjohur të sportit Xhavit Kajtazi. Kjo monografi voluminoze ndriçon pesë dekada të zhvillimeve sportive në Kosovë, duke përfshirë shkrimet dhe kontributin e Xhavit Kajtazit që nga viti 1979 deri në 2023. Përmes kësaj vepre, autori synon të sjellë një panoramë të plotë të ndikimit të Kajtazit në sport, gazetari dhe letërsi, duke i dhënë vlerë të jashtëzakonshme historike dhe kulturore vendit tonë. Në promovimin e kësaj monografie morën pjesë figura të njohura të sportit dhe publicistikës. Autori i librit, Veli Kajtazi theksoi se kjo monografi synon të shërbejë si një burim i vlefshëm për studiuesit, studentët dhe të gjithë ata që interesohen për historinë dhe sportin në Kosovë. "Xhavit Kajtazi ka pasur një rol të veçantë dhe të spikatur për pesë dekada, duke kontribuar jo



vetëm në gazetari sportive, por edhe në trajnim, muzikë dhe letërsi", tha autori i kësaj monografie. Para të pranishmëve folën edhe Ismet Krasniqi, kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Malësor Gjonbalaj, profesor në Fakultetin e Edukimit dhe Sportit, të cilët vlerësuan lart kontributin e Xhavit Kajtazit në gazetarinë sportive, por edhe si trajner i volejbollit. Rrugëtimin e tij Xhavit Kajtazi e nisi si muzikant, për t'iu dedikuar më pas volejbollit, ku dha një kontribut të çmuar si lojtar dhe trajner. Ai ndihmoi brezat e rinj të volejbollistëve që sot janë emra të njohur të sportit në Kosovë. Përveç angazhimit të drejtpërdrejtë në sport, Kajtazi shkëlqeu si gazetari sportiv, duke

ndikuar në zhvillimin e kësaj fushe përmes qindra intervistave, reportazheve dhe artikujve të tij. Në periudhën më të vështirë të pavarësimit të sportit të Kosovës nga ish-shteti federativ dhe kohën e okupimit nga Serbia, ai luajti një rol të rëndësishëm duke informuar publikun për zhvillimet sportive dhe sakrificat e sportistëve e gazetarëve të kohës. Ndërkaq, pas luftës bashkë me vëllanë e tij Besimin, botuan për herë të parë gazetën e përjavshme sportive "Kosova Sport", duke edukuar njëherësh një brez të ri të gazetarëve sportivë, të cilët sot janë emra të shquar. Të gjitha këto, të dokumentuara me saktësi, janë përfshirë në këtë monografi, e ku me shkrime kanë kontribuar edhe gazetarë të shumtë sportivë. Në fund të ceremonisë, drejtuesi i shtypshkronjës "Lena Graphic", Hajdar Fejzullahu ndau një plaketë nderi për Xhavit Kajtazin, duke e cilësuar atë si një figurë frymëzuese për brezat e rinj. Botimi i kësaj monografie u mundësua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Phoenixi triumfon ndaj Lakersave, Milwaukee tejkalon krizën

PHOENIX, 27 NËNTOR - Skuadra e Phoenix Suns mposhti Lakersat. Në sfidën më të rëndësishme të mbrëmjes së të martës në NBA, vendasit mposhtën kalifornianët me shifrat 127-100, në një përballje mes dy ekipeve rivale në Konferencën e Perëndimit. Davis realizoi 25 pikë e 15 rebound për Lakersat, por që s'mjaftuan. Ndërkohë që për Suns u dalluan Booker me 26 pikë si dhe Durant e Beal me nga 23 pikë secili. Fitore të vështirë korri Milwaukee Bucks, që mundi me rezultat 106-103 Miamin në fushën e këtij të fundit. Lillard me 37 pikë e 12



asistime ishte lider në fushë për miqtë, duke rikthyer Milwaukee në shinat e duhura, pas një nisje të sezonit shumë negative. Nuk zhgënjën ekipi i Chicago Bulls, që triumfoi me rezultat 127-108 ndaj Washingtonit në transfertë, ku protagonist ishte Coby White me 21 pikë. Vijon ndërkohë ecuria

pozitive e texanëve të San Antonio Spurs, e cila mposhti me shifrat 128-115 Utah Jazz, sfidë ku rikthehet protagonist Wenbanyama, që realizoi 34 pikë për Spurs. Në sfidën tjetër ekipi i Houstonit, falë 27 pikëve e 11 rebound të VanVleet, mundi me rezultat 117-111 Minnesotan jashtë fushe.

REZULTATET

Washington - Chicago	108-127
Miami - Milwaukee	103-106
Minnesota - Houston	111-117
Utah Jazz - San Antonio	115-128
Phoenix - Lakers	127-100

Djali i Leo Messit debuton në Argjentinë

Me të njëjtin numër si babai i tij, numri 10, e njëjta fanellë rozë, ajo e Inter Miami. Thiago Messi, djali i madh i yllit të futbollit botëror, ka debutuar në turneun "Newell's

Cup" në qytetin argjentinas të Rosarios. 12-vjeçari u përball me nikoqirët, duke humbur 1-0 në kompeticionin e rezervuar për lojtarët nën 13-vjeçar. Thiago

luajti së bashku me Benjamin Suarez, djalin e sulmuesit uruguian Luis Suarez, shoku i skuadrës së Leo Messit në Miami, si dhe në vitet e kaluara te

Barcelona. Ai u zëvendësua në pjesën e dytë. E ëma e "djalit të artit", Antonela Rocuzzo dhe disa anëtarë të familjes së tij, mes tyre gjyshërit Jorge Messi dhe

Celia Cuccitini, ishin të pranishëm në tribuna për të mbështetur vogëlushin, i cili mban mbi supe një mbiemër shumë të rëndë.

SHKURT

Muriqi suspendohet me dy ndeshje

Mallorca do të jetë pa sulmuesin Vedat Muriqi për dy ndeshjet e ardhshme në kampionatin spanjoll. Muriqi është suspenduar me dy ndeshje pas ndëshkimit me karton të kuq që e mori vikendin e kaluar në kuadër të La Ligas. Ai u përjashtua direkt nga loja kundër Las Palmasit në minutën e 88-të për shkak të veprimit të pahijshëm që e bëri ndaj lojtarit kundërshtar, por Mallorca arriti ta fitoj ndeshjen me rezultatin 3-2. Shkaku i suspendimit, sulmuesi i Kosovës do t'i mungoj Mallorcës në dy ndeshjet e radhës, të premtën kundër Valencias dhe të martën e ardhshme ndaj Barcelonës. Ai do të rikthehet në fushë më datën 6 dhjetor apo në përballjen që Mallorca e luan në udhëtim ndaj Celta Vigos. Aktualisht, Mallorca është e teta në tabelë me 21 pikë kurse Muriqi ka shënuar 2 gola dhe ka bërë 1 asistim në 11 ndeshje kampionale këtë sezon.

Kompany: Zhvilluam një ndeshje të madhe ndaj PSG-së

Bayern Munchen fiton sfidën e fortë ndaj kampionëve francezë të PSG-së (1-0). "Bavarezët" u mjaftuan me një gol të Kim Min- Jae, i cili përfitoi nga një rrëmujë në zonë për ta shtyrë topin drejt rjetës. I lumtur pas ndeshjes ishte tekniku belg Vincent Kompany. "Zhvilluam një ndeshje të madhe dhe e merituar fitore. Nuk jam i surprizuar nga vendosja taktike e PSG-së, ata luajnë shpesh herë pa një sulmues të deklaruar. Jam i kënaqur pasi na shërben shumë kjo fitore", ka thënë Kompany.

Enrique: Kemi edhe tre ndeshje, besojmë te kualifikimi

I zhgënjyer pas humbjes nga Bayern Munchen është shfaqur trajneri i PSG-së, Luis Enrique, i cili ka thënë se janë paraqitur keq në këtë ndeshje, por ai beson se klubi francez mund të kualifikohet tutje. "Bayern ishte superior në pjesën e parë, lamë një impresion të keq në këtë ndeshje. Në pjesën e dytë u futëm në fushë me një tjetër mentalitet, por pas daljes nga loja të Dembeles, vuajtëm shumë. Kemi edhe tri ndeshje të mbetura, shpresoj të kualifikohemi", ka thënë Enrique.

Inzaghi: Duam të shkojmë deri në finalen e Ligës së Kampionëve

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, foli për mikrofonët e "Sky" pas fitores 1-0 kundër Leipzigit, në Ligën e Kampionëve: "E dinim rëndësinë e ndeshjes. Luanim kundër një skuadre me vlera, e cila deri të dielën kishte mbrojtjen më të mirë të Bundesligës. Bëmë një ndeshje shumë të mirë, ishim gjithmonë të balancuar, edhe pse kundër Leipzig nuk është e lehtë. Më vjen keq që nuk e shënuam golin e dytë, por skuadra vuajti relativisht pak. Patjetër jemi të kënaqur, por për të arritur në tetë më të mirët duhet edhe një hap tjetër. Kemi bërë një rrugëtim të shkëlqyer: 4 fitore radhazi dhe 5 ndeshje pa pësuar gol". "Finalja është objektivi i të gjitha skuadrave, aq më tepër për mua që drejtoj Interin. Ka shumë konkurrencë dhe nuk është e lehtë të luash çdo dy ditë e gjysmë. Kam fatin të kem djem që janë mësuar me këtë, ka një gatishmëri të madhe nga të gjithë", ka shtuar Inzaghi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Faton Fejzullahu me nr. të protokollit 7118/23 të datës 05.12.2023 për parcelën kadastrale 00139-13, që ndodhet në Fshatin turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri” në Komunën e Prizrenit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e “Objektit për banim – turizëm fshatar” në Fshatin Turistik në Prevallë të Komunës së Prizrenit.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.11.12.2024 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Tokë ndërtimore	
b. Vija rregulluese.	m'
c. Vija e ndërtimit.	1.0 m 3.0 m 9.80 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	h=10.15m' d=9.8m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	h=10.15 m' d=9.60m d=2.01 m d=1.00m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	20 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	80 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	20 %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	-
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Gurë, dru dhe tullë
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Emrula Saiti shpall te pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Enis Kurtaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Lola Velikovic shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- FLAMUR SADIKU, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLT “ARKITEKT SINANI” .
- P.G.P KOLASIN, shpall te pavlefshme certifikatën e Tvsh-së: 330053166, biznesi me NUI: 810696651.
- Flandra Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi “ Prizren.
- Artan Quni shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2024 shpall:

KONKURS

- (1) Këshilltar shkencor për kohën bashkëkohore 1912 - 2008 - zgjedhje;
- (1) Bashkëpunëtor shkencor për shek. XVI – XVIII - zgjedhje;
- (1) Bashkëpunëtor shkencor për shek. XIX fillimin e shek. XX- zgjedhje;

Kandidatët për Këshilltar shkencor përveç tjerash duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
- Të ketë së paku 2 (dy) vepra shkencore monografike dhe vëllime me dokumente të botuara nga Institucionet kërkimore shkencore, akademitë dhe universitetet; të ketë të botuara së paku 5 (pesë) punime shkencore në revista relevante ndërkombëtare në kuadër të periudhës, sipas rregullores dhe akteve në fuqi.
- Të tregoj nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për periudhën historike përkatëse, e cila duhet të dëshmohet.
- Të ketë pjesëmarrje në konferenca shkencore së paku në tri (3), nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- Përvojë në projektet e kërkimeve shkencore së paku në dy (2), të cilët janë të udhëhequra nga institucionet shkencore, akademike dhe universitare shtetërore.
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike

Kandidatët për Bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare, në kuadër të periudhës, sipas rregullores dhe akteve në fuqi.
- Të tregoj nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për periudhën historike përkatëse, e cila duhet të dëshmohet.
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Të ketë pjesëmarrje në konferenca shkencore, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- Aftësi për kërkime shkencore.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse;
- Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi.
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, "Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve" dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në adminstatën e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, në adresën Eqrem Qabej nr. 111.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Na osnovu Zakona Br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, Br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini (01B-195, od 31.10.2024. godine), člana 8 zakona Br. 03/L-212 o Radu, i Uredbe o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju i drugim relevantnim aktima Instituta, Naučno veće Instituta za istoriju "Ali Hadri" – Priština na sastanku održanom 27.11.2024. godine objavljuje:

KONKURS

- (1) Naučni savetnik za za savremeno vreme 1912-2008 – izbor;
- (1) Naučni saradnik za XVI-XVIII vekove – izbor;
- (1) Naučni saradnik za XIX početkom XX veka - izbor;

Kandidati za naučnog savetnika, između ostalih, moraju ispuniti sledeće uslove:

- Da imaju stepen doktora nauka;
- Da imaju najmanje 2 (dva) monografska naučna rada i tomove dokumenata u izdanju naučnoistraživačkih ustanova, akademija i univerziteta; da imaju najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima iz odgovarajuće oblasti, u skladu sa važećim propisima;
- Pokazati visok nivo kompetentnosti i naučnog praksa za relevantni istorijski period, što se mora dokazati;
- Da učestvuju na najmanje tri (3) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna
- Praksa u naučnoistraživačkim projektima u najmanje dva (2) koje vode naučne, akademske i državne univerzitetske institucije;
- Sposobnost vođenja istraživačko-naučnih i akademskih projekata.

Kandidati za naučnog saradnika moraju ispuniti sledeće uslove:

- Da imaju stepen doktora nauka;
- Da imaju najmanje (1) naučni rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima iz odgovarajuće oblasti, u skladu sa važećim propisima i aktima;
- Pokazati visok nivo kompetentnosti i naučnog praksa za relevantni istorijski period, što se mora dokazati;
- Da je učestvuje u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje;
- Da učestvuje na naučne konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna;
- Sposobnost za naučno istraživanje.

Potrebna dokumentacija

Kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Diploma o završenim relevantnim studijama;
- Diplome stečene u inostranstvu moraju biti overene u skladu sa zakonima na snazi;
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Biografija uz koga se moraju priložiti potrebni dokazi za dokazivanje situacije koja je u njoj prikazana;
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor naučnoistraživačkog osoblja Instituta za istoriju "Ali Hadri" vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 za istraživačko-naučnu delatnost (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za istoriju "Ali Hadri" – Priština (01B-195, od 31.10.2024.) , člana 8. Zakona o radu br. 03/L212, "Pravilnikom o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača" i drugi relevantni akti Instituta.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, kao i na sajtu Istorijeskog instituta "Ali Hadri".

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koja su potrebna za radno mesto za koje konkuriraju.

Popunjeni zahtevi se podnose i evidentiraju u upravi Instituta za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, na adresi Ekrem Cabej br. 111.



TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

